

Nr.Prot 1126/1

Tiranë, më 27/01 / 2022

Drejtuar: Entit Rregullator të Energjise

Adresa: Blvd "Bajram Curri", Rr. Viktor Eftimiu, 1023

Lënda: Kthim përgjigje shkresës nr.916/1 datë 16 .12.2021

I nderuar zoti Ahmeti,

Në përgjigje të shkresës nr. 916/1 datë 16.12.2021 (Prot ERE), nëpërmjet së cilës kërkohet marrja e mendimit të shoqërisë OSSH sh.a lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së bërë nga Inspektorati Teknik dhe Industrial (ISHTI), për disa shtesa dhe ndryshime në "Rregulloren e Lidhjeve të Reja në Sistemin e Shpërndarjes" të miratuar me vendimin e Bordit të ERE Nr. 166, datë 10.10.2016, i ndryshuar, shprehemi si më poshtë:

Bazuar në vendimin e ERE nr 247 datë 13.12.2021 specifikohet se kërkohen shtesat në rregulloren e lidhjeve të reja si më poshtë:

- 1- Tek pjesa 2, "Dokumentacioni i kërkuar për aplikim për lidhje të re", për lidhjet e reja në TU, në pikën 2.1, pas pikës 2.1.6, propozohet të shtohet pika 2.1.7 me përmbajtje: Vërtetimin e regjistrimit pranë ISHTI-T përpara vënies në shfrytëzim (dhënies së tensionit) vërtetuar me dokumentin përkatës.
- 2- Tek pjesa 2, "Dokumentacioni i kërkuar për aplikim për lidhje të re", për lidhjet e reja në TU, në pikën 2.1, pas pikës 2.1.8, propozohet të shtohet pika 2.1.8 me përmbajtje: Deklaratë instalimi dhe protokoll tokëzimi, i lëshuar nga inxhinier elektrik i pajisur me licencë.

Për pikën e dytë, përmbajtjen e të cilës ju propozoni të shtohet në pikën 2.1.8, vlerësojmë se është lapsus, pasi aktualisht ekziston përkatësisht në pikën 2.1.6 në të cilën ndër dokumentat e kërkuara specifikohet: "Deklaratë instalimi dhe protokoll tokëzimi, i lëshuar nga inxhinier elektrik i pajisur me licencë".

Për pikën e parë, lidhur me shtimin e një dokumenti të quajtur Vërtetim regjistrimi pranë ISHTI, shprehemi se Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial, mund të kryejë të gjitha inspektimet e nevojshme si përpara apo pas vënies në shfrytëzim të instalimeve, sipas kompetencave që i njeh ligji, pa ngatërruar këtë moment, me miratimin e pikës së lidhjes dhe përcaktimin e sistemit të matjes që është e drejtë ekskluzive e OSSH-së.

Në kuadër të prioriteteve të qeverisë shqiptare, politikat dhe strategjitë kombëtare që synojnë përmirësimin e shërbimeve publike, kanë një fokus të veçantë në ofrimin e shërbimeve publike, që synon përmirësimin rrënjësor të përvojës së qytetarëve sipas parimit: qytetari në qendër.

Reforma e derregullimit, lehtësimi i procedurave për qytetarët dhe sipërmarrjen ka për qëllim të ndryshojë rrënjësisht mënyrën sesi ofrohen shërbime publike, të thjeshtohen sa më shumë procedurat, të eliminohen dokumentet, lejet, licencat apo autorizimet e panevojshme, që institucionet shtetërore kërkojnë në këmbim të ofrimit të shërbimeve, pa cënuar sigurinë, dhe mbrojtjen e jetës, shëndetit, konkurrencës dhe funksionimit të tregut. Në të njëjtën kohë, shërbimet publike dhe administrata shtetërore afrohen sa më pranë qytetarit dhe sipërmarrësit, duke iu përgjigjur sa më mirë nevojave të tyre. Në këtë kuadër, ndër të tjera për çështjet e furnizimit me energji elektrike, përfitues kryesorë të reformës së derregullimit janë qytetarët dhe sipërmarrësit. Si rezultat i kësaj reforme mundësohet lehtësimi i mëtejshëm i shërbimeve për qytetarët dhe bizneset duke eliminuar dokumente të cilat nuk do të kërkojnë më prej tyre për asnjë shërbim të ofruar, si dhe shumë dokumente mund të merren drejtpërdrejt nga platforma elektronike të vetë institucioneve, përmes ndërveprimit me platformën elektronike e-Albania, ose ndërveprimit dhe komunikimit me institucionet publike përkatëse.

Lidhur me sa më sipër, vlerësojmë se propozimi i paraqitur nga ISHTI vjen në kundërshtim me frymën e derregullimit dhe të lehtësimit të procedurave, ndërkohë që mund të bëhet pjesë e procedurave të brendshme të këtij institucioni, në përputhje me kompetencat, përgjegjësitë dhe detyrat me të cilat e ka ngarkuar kuadri ligjor për inspektimin.

Theksojmë se shtimi i elementëve të tjerë që shoqërohen me dokumentacionin e kërkuar do të ndikojë dukshëm në zgjatjen e afateve në procedurat e lidhjeve të reja.

Me konsideratë,

Petra LIKA

Administrator

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sha